



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE - MINISTARSTVO ZA DIJASPORU I STRATEŠKE INVESTICIJE - MINISTRY OF DIASPORA AND STRATEGIC INVESTMENTS			
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	02	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	680
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	02	Data: Datum: Date:	22.05.2018
Prishtinë			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike – Ministarstvo za Dijasporu i Strateška
Ulaganja - Ministry of Diaspora and Strategic Investments
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm-Kancelaria Generalni Sekretara- Office of the Secretary

Nr. ____/2018
Dt. 22.5.2018

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenet 4.1.7 të Ligjit nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën, në pajtim me nenin 17 (paragrafët 5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011) dhe Rregulloren nr. 07/2011, Rregulloren nr. 14/2017, Rregulloren nr. 15/2017 dhe Rregulloren nr. 16/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 02/2011, nenit 10. paragrafi 2. të Rregullores Nr. 01/2016 për kriteret dhe mënyrën e subvencionimit të projekteve për diasporën, bazuar në thirrjen publike për mbështetje financiare (subvencioneve) të MDIS, të dt. 03/04.2018. u.d. Sekretari i Përgjithshëm nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin të projekteve për mbështetje financiare për individë-personave fizik, në fushën e ruajtjes së identitetit dhe fuqizimit të lidhjeve me diasporën, si dhe në përfshirjen e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik.
2. Komisioni, i formuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet si në vijim:
 - 2.1. Ejup Kamberaj, kryesues;
 - 2.2. Ymer Avdiu, anëtar;
 - 2.3. Ibrahim Kadriu, anëtar;
3. Komisioni, sipas pikës 2 të këtij vendimi, është përgjegjës ta bëjë vlerësimin e projekteve të individëve-personave fizik, të paraqitura në MDIS, në pajtim me kriteret e përcaktuar sipas Rregullores Nr. 01/2016, për kriteret dhe mënyrën e subvencionimit të projekteve për diasporën

4. Komisioni, sipas pikës 2 të këtij vendimi, pas vlerësimit të kryer të projekteve, duhet t'i rekomandoj sekretarit të përgjithshëm për rezultatin e vlerësimit, me qëllim të nxjerrjes së vendimit për subvencionimin e projekteve
 5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
-

Vendimi u dorëzohet:

- Kabinetit të Ministrit të MDIS-it;
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të MDIS-it.

Shyhrete Gosalec

u.d. Sekretare e Përgjithshme

